



Në bazë të nenit 25 të Statutit të Komunës së Deçanit, nenet 5 dhe 17 pika (f) dhe (p) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, duke u mbështetur në Rregulloren nr.02/2013 Mbi Kriteret për Krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe Ligjit nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.27.05.2015, nxjerrë këtë :

V E N D I M

PËR SHFUQIMIZIMIN E VENDIMIT MBI THEMELIMIN E NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE

I.

Me këtë Vendim shfuqizohet Vendimi I Kuvendit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.VI-7,dt.26.09.2014, për Themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale “Higjiena Sh.A” e organizuar si Shoqëri Akcionare.

II.

Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Kuvendi I Komunës.

Arsyetim:

Bazuar në Rekomandimin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal-Departamenti për shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve të Kuvendeve Komunale, të dt.24.10.2014, nr.protokolit:0204-1386/2, me të cilin kërkohet rishqyrtimi I vendimit të Kuvendit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.VI-7,dt.26.09.2014, për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale “Higjiena Sh.A” e organizuar si Shoqëri Akcionare.

Me Rekomandimin e MAPL kërkohet që vendimi në fjalë të bëhet :Vendim për Inicimin e procedurës për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale, duke u mbështetur në Ligjin nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L—87 për Ndërmarrjet Publike Lokale në pajtim me kriteret e përcaktuara me akt nën ligjor të Qeverisë.

01.Nr.V-4
Deçan, dt.27.05.2015

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit:
Jashar Dobraj

HYRESE-ULAZNA-WIGOSING	
REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA E DEÇANIT • OPŠTINA DECANI • DEÇAN MUNICIPALITY	
Nga: <u>KIK-Deçan</u>	Nr Prot: <u>12132</u>
Që: <u>01</u>	Bz Prot: <u>05-06-15</u>
From: <u>01</u>	Prot. No. <u>20</u>
Nr i faqeve: <u>01</u>	Date: <u>05-06-15</u>
Rr. Shumica: <u>01</u>	Date: <u>05-06-15</u>
No. Pages: <u>01</u>	Date: <u>05-06-15</u>
DECAN, DECANI	

